Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ / Ekspert Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. lëndës:
_____	**06.07.2022**	**08.07.2022**	**240/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Më datën: 29.06.2022, ne cilësi të ankuesit, z. Armir QOROLLI, ka parashtruar ankesë me nr. **240/22**, kundër propozimit për dhënie te kontratës ne lot 1, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Angazhimi i Eksperteve për Autoritetin e Aviacionit Civil te Kosovës, me nr prok: 2016-22-29-76-2-2-1, iniciuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim**.**
Vlera e parashikuar për Lot 1 – 36 000.00€
Lot 2 – 18 000.00€

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE ANKUES

Neni 4 parag/ 1.75 i LPP nr. 04/L-042 lidhur me Ligin nr. 05/L -068 - Konfliktet e Interesit;
Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim;
Neni 59 parag. 4 Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 60 parag. 1 nënparag 1.1 dhe 1.2 - Kriteret për Dhënien e Kontratës;
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe Profesionale;

Neni 37 dhe 38 i Ligjit për Aviacion Civil nr. 03/L-051
DEKLARATA DETALE E ANKESES

Shkelja e nenit 4 parag. 1.75 të LPP - Konflikt i Interesit- Ka të bëjë me faktin se konkurenti i përzgjedhur Ersen Shileku është mik i ngushtë i drejtorit të AK (Autoritetit të Aviacionit Civil) z. Bujar Ejupi gje qe ka ndikuar ne te ket dyshime per mungesë objektiviteti në përzgjedhje të kandidatit. Për këtë i ofroj si **provë një fotografi** nga rrjeti social Facebook ku shihet drejtori i lartëpërmendur me kandidatin e përzgjedhur bashkarisht duke pirë kafe.

Shkelja e nenit 7 të LPP - Barazia në trajtim - Me vetë faktin se kemi të bëjmë me konflikt të interesit sic e cekëm më lartë, kjo ka lidhmëri të logjike se në këtë tender kemi të bëjmë me diskriminim dhe mungesë të

barazisë në trajtim, që nga fillimi e deri në fund, sepse ankuesi nuk është trajtuar barabartë dhe autoriteti kontraktues në këtë rast drejtpërdrejt apo tërthorazi dyshohet se ka pasur ndikim në konkurencën në mes operatorëve ekonomik.

Shkelja e **nenit 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve** — Autoriteti kontraktues nuk ka ekzaminuar dhe vlerësuar drejtë tenderin në fjalë, sepse nuk ka marrë parasysh dhe analizuar përshtatshmërinë në mes kërkesave në bazë të dosjes së tenderit dhe kualifikimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesës, edhe pse ka paraqitur dokumentet përkatëse të cilat e dallojnë nga të gjithë konkurentët tjerë sepse profesionalisht posedon të gjitha kushtet e kërkuara në bazë të kualifikimit dhe eksperiencës së tenderit ato nuk janë marrë parasysh nga autoriteti kontraktues.

Parashtruesi i ankesës posedon: Licencë të Pilotit, Diplomë Universitare të drejtimit të Trafikut Ajror dhe Transportit dhe është pjesëmarrës i organizatës ndërkombëtare AOPA, e pranuar globalisht si organizatë për trajnime të ndryshme të aviacionit, pozitë të cilën ka kërkuar Autoriteti kontraktues.

Në dosjen e tenderit kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë njohuri të përgjithshme të aviacionit, aerodromeve, navigimit ajror, sigurisë së fluturimeve dhe Rregullimit Ekonomik, të ketë përfunduar një trajnim profesional në fushën e aviacionit nga Institucione ndërkombëtare të aviacionit. Për këtë askush nga kandidatët dhe as kandidati i përzgjedhur nuk kanë njohuritë e mësipërme sikurse parashtruesi i ankesës sepse është PILOT dhe nuk mund që askush të ketë njohuri nga rregullat e përgjithshme e të veçanta të aviacionit sikurse një PILOT, sepse edhe pozita e kërkuar titullohet **‘’Ekspert- Konsulent i Aviacionit”,** ndërsa AK nuk ka marrë parasysh fare këto karakteristika dhe kualifikime akademike dhe trajnime profesionale kredibile e adekuate të ankuesit, duke menduar me apo pa qëllim se një person me profil tjetër akademik si psh ekonomist, inxhinier etj mund të ketë njohuri më shumë për aviacion sesa një Pilot

Shkelja e nenit 37 dhe 38 e Ligjit Për Aviacionin Civil nr. O3/L-O51 -

Në nenin 37 të Ligjit të sipërshënuar thuhetÇdo person i cili vepron si personel i aviacionit duhet të posedojë licencën dhe klasifikimin përkatës të lëshuar apo të shpallur te vlefshme nga AAC-ja sipas këtij Ligji dhe rregulloreve përkatëse të zbatimit. Klasifikimi nënkupton çdo shënim në licencë i cili i thekson kushtet, privilegjet apo kufizimet speciale. Kjo dispozitë aplikohet edhe për personelin e navigimit ajror dhe të mirëmbajtjes si dhe për zyrtarët e operimeve të fluturimit, operatorët e stacionit aeronautik dhe për instruktorët e fluturimit".

Në anën tjetër autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar këtë dispozitë ligjore duke përzgjedhur personin që nuk posedon licencë kurse e ka diskualifikuar operatorin ekonomik-ankuesin i cili ka licencë të pilotit dhe kualifikimet akademike Neni 38 i Ligjit për aviacionin thuhet:

"Licencal dhe klasifikimet e personelit të aviacionit të lëshuara apo të njohura si të vlefshme në një vend të huaj shpallen të vlefshme nëse kushtet në bazë të së cilave janë lëshuar ato licenca dhe klasifikime janë të njëjta apo më të larta se standardet e themeluara sipas këtij ligji'

Autoriteti kontraktues derisa obligohet që ta zbatojë dispozitën e lartëcekur ligjore, ne vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk e ka njohur kualifikimin dhe licencën e Pilotit AOPA-s (The Aircraft Oëners and Pilots Association), e cila pasqyron qartë se ankuesi plotëson të gjitha kushtet ligjore për kualifikim të parapara në këtë tender.

Derisa Autoriteti Kontraktues pretendon në gabim teknik në çmim të tenderit, ankuesi pretendon se përshkrimi i cmimit të tenderit është vënë në rregull ashtu sic lejon edhe sistemi e-prokurimi, çmimi për njësi (muaj) 520 Euro, dhe cmimi total 18.720 Euro dhe për këtë edhe autoriteti kontraktues fillimisht është pajtuar kurse më vonë e ka konsideruar gabim teknik. Për këtë paraqesim si dëshmi fotografinë e ngarkuar në sistem të dosjes,

dhe që kjo detyron Autoritetin kontraktues që të përmirsojë gabimet në një tender të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse ato zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve.

Neni 60 LPP- Kriteret për Dhënien e Kontratës - Ankuesi ka aplikuar me cmimin më të ulët. Ky nen e detyron autoritetin kontraktues që kontratën publike të ia jap operatorit ekonomik me cmim më të ulët dhe tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën e specifikuar në dosjen e tenderit. Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë parasysh këtë kriter, duke ia dhënë - rekomanduar të përzgjedhurit i cili e ka pasur cmimin më të lartë të ofertuar.

Neni 69 - Aftësia teknike dhe Profesionale -
Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomik sa i përket kualifikimeve dhe eksperiencës për pozitën Ekspert-Konsulent i aviacionit të plotësojë këto kushte:

KUALIFIKIMET DHE EKSPERIENCA -

Personi fizik duhet të dorëzojë CV;
Personi fizik duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e inxhinierisë, ekonomisë ose të aviacionit/dëshmi, diplomë universitare;
Personi fizik duhet të ketë mnimum 5 vite përvojë pune në aviacion, menagjeriale në fushën e aviacionit;
Personi fizik duhet të ketë përfunduar së paku një trajnim profesional në fushën e aviacionit nga institucionet ndërkombëtare të aviacionit, IATA, ACI,Eurocontrol.

Autoriteti kontraktues në këtë rast ka shkelur edhe këtë nen sepse në bazë të dokumentacioneve të tenderit, vlerësimit dhe ekzaminimit, nuk ka arritur që të analizojë drejtë shkathësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë, trajnimet, përvojën e punës, licencën e pilotit, diplomën universitare, etj të cilat padyshim se e bëjnë personin adekuat për pozitën dhe titullin e kërkuar nga Autoriteti KontraktuesKërkojë nga OSHP që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ta aprovojë ankesën si të bazuar, të anulojë/ndryshojë cdo veprim të Autoritetit Kontraktues dhe të ndërmarrë gjithë hapat ligjor në kuadër të kompetencave të saj.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale
Kërkesa 1.
Personi Fizik duhet të jetë i pajisur me dokument valid identifikimi të Republikës së Kosovës (kjo kërkesë vlen për dy lotet)
Kërkesa 2.
Personi Fizik duhet të ketë kualifikim universitar në fushën e inxhinierisë, ekonomisë ose të aviacionit (kjo kërkesë vlen vetëm për Lot1),
Kërkesa 3.
Personi Fizik duhet të ketë kualifikim universitar në fushën e Teknologjisë Informative ose ekonomisë (kjo kërkesë vlen vetëm për Lot2),
Dëshmia 1.
Kopja e dokumentit të identifikimit (kjo dëshmi vlen për dy Lotet)
Dëshmia 2.
Kopja e diplomës e kualifikimit universitar (kjo dëshmi vlen për Lot1)
Dëshmia 3.
Kopja e diplomës e kualifikimit universitar (kjo dëshmi vlen për Lot2

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
Kërkesa 1.

Personi Fizik duhet të ketë të përfunduar së paku një trajnim profesional në fushën e aviacionit nga institucionet ndërkombëtare, IATA, ACI ose EUROCONTROL (kjo kërkesë vlen vetëm për Lot1),
Kërkesa 2.
Personi Fizik duhet të ketë minimum 5 vjet përvojë pune në aviacion, nga 5 vite përvojë pune ti ketë minimum 3 vjet pune në pozitë menaxheriale në fushën e aviacionit. (kjo kërkesë vlen vetëm për Lot1),
Kërkesa 3.
Personi Fizik duhet të ketë minimum 3 vjet përvojë pune ne menaxhimin e projekteve (kjo kërkesë vlen vetëm për Lot2),
Dëshmia 1.
Kopje e diplomës apo certifikatës për trajnimin përkatës (kjo dëshmi vlen vetëm për lot1)
Dëshmia 2.
CV dhe kopjet e kontratave që dëshmojnë përvojën e punës (kjo dëshmi vlen vetëm për Lot1)
Dëshmia 3.
CV dhe kopjet e kontratave që dëshmojnë përvojën e punës (kjo dëshmi vlen vetëm për Lot2)

Dokumentet që përbejnë Tenderin (13.1-FDT)
Ofertuesi/kandidati përveç dëshmive mbi kërkesat të lartcekura duhet të dorëzoj edhe një propozim i cili duhet të përshkruaj përshtatshmërinë profesionale, qasjen dhe metodologjinë ndaj pozitës dhe detyrave të punës të specifikuara në terma të referencës.
(kjo kërkesë vlen për te dy lotët)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike
Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve për vlerësimin e Propozimeve Teknike janë:

Pikët

Kualifikimet Minimale	**Kalon/Nuk kalon**
Përvojë specifike	**10-40**
Metodologjia e punës / detyrave të punës	**10-20**
Kualifikimi	**20-40**
Pikët totale	**100**

Nota teknike minimale Nt që kërkohet për të kaluar është **60** nga **100** pikë të mundshme.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES.

Ska

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga z. Armir QOROLLI, kundër propozimit për dhënie te kontratës ne lot 1,per AP: "Angazhimi i Eksperteve për Autoritetin e Aviacionit Civil te Kosovës, me nr. prok: 2016-22-29-76-2-2-1, iniciuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP.

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - "Agjencioni Qendror i Prokurimit", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim (kornizë 36 muaj) me vlerë të mesme. Kriter i dhënies është përcaktuar tenderi ekonomikisht me i favorshëm.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore (neni 113) : Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore përkatësisht procedurës se aplikuar, kërkesave te kualifikimit dhe termave te referencës te aplikuara ne dosje te tenderit pretendimet ankimore i kualifikojmë si te bazuara pasi qe:

- Aplikimi i kësaj procedure te prokurimit bie ndesh me dispozitat ligjore dhe parimet bazike te prokurimit publik përfshire konkurrencën dhe transparencën. Përkatësisht dispozitat e nenit 1, te LPP-se, pasi që ne ketë procedure te prokurimit nuk kemi te bëjmë me procedurë për blerje apo marrje te shërbimeve te veçanta por sipas termeve te referencës te përcaktuara ne aneksin 1, te dosjes se tenderit kemi te bëjmë me rekrutim te stafit. Me poshtë po i pershkruajm objektivar dhe detyrat te përcaktuara ne aneksin 1, te dosjes se tenderit:

Pika 2. Objektivi

Objektivat kryesore qe synohen nëpërmjet këtij aktiviteti janë:

- *Krijimi i kapaciteteve ne zyrën e drejtorit te përgjithshëm, me përvoje dhe ekspertize te mjaftueshme ne fushën e aviacionit për përmirësimin e sistemit te raportimit dhe llogaridhënies brenda AAC-së*
- *Gatishmëria e AAC-se për t'ju përgjigjur sfidave dhe kërkesave për zhvillim dhe avancim te mëtutjeshëm te implementimit te standardeve ndërkombëtare te Aviacionit Civil duke përkrahur drejtorit e përgjithshëm në përmirësime të vazhdueshme të sistemit të sigurisë në aviacionin civil ne R. e Kosovës*

3. Detyrat dhe përgjegjësitë

Eksperti i përzgjedhur dhe angazhuar, në bashkëpunim të ngushtë me stafin e AAC-së në AAC, ofron shërbime, kryen detyra dhe ka përgjegjësi si në vijim*:*

- *Këshillon Drejtorin e Përgjithshëm për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës, duke sugjeruar përmirësime të vazhdueshme të sistemit të sigurisë në aviacionin civil ne R. e Kosovës;*

• Ofron kontribut profesional në ngritjen, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm në aviacion civil në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi;

• Përcjell trendët dhe zhvillimet e të dhënave të sigurisë dhe kryen analizat dhe vlerësimet e të dhënave të sigurisë se aviacionit civil;

• Asiston në koordinimin e aktiviteteve të nevojshme në AAC-së për zbatimin e kërkesave për menaxhim të sistemit që burojnë nga rregulloret e BE-së;

• Ofron mbështetje profesionale në fushën e aviacionit në mënyrë efikase dhe brenda afateve kohore;

• Kryen detyra dhe projekte të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm, me synim të përmbushjes së vizionit, misionit si dhe qëllimeve strategjike të AACK-së.

• Koordinon departamentet brenda AAC duke monitoruar dhe verifikuar përmbushjen e standardeve dhe praktikave të rekomanduara ne aviacion civil.

• Të ketë integritet; vetë-iniciativë dhe motivim; aftësi për të zotëruar respekt; aftësi për të punuar nën presion; t'i kushtojë vëmendje detajeve dhe afateve kohore; të jetë pjesëtar i ekipit; aftësi të mira komunikimi; ***dhe të jetë fleksibil ndaj orarit të punës****;*

• Njohuri në të folur dhe në të shkruar ***të gjuhës angleze****.*

• Njohuri të mira të Microsoft Office-it, programeve Word, Excel, PowerPoint, etj.

• Aftësi për të formular qartë dhe thuktë mendimet në të shkruar dhe të folur;

AK – AQP, si kriter te dhënies se kontratës ka përcaktuar "*Tenderi Ekonomikisht me i Favorshëm*", rrjedhimisht sipas kërkesave te kualifikimit nuk ka definuar pragun e kërkesave dhe nuk ka aplikuar nen kritere te vlerësimit dhe nuk janë harmonizuar me specifikimet teknike te detyrueshme siç parashihet me dispozita te LPP-se, përkatësisht nenit 20.9, te RrUOPP-se, ku përcaktohet: *"Specifikimet teknike janë të kërkesa të* ***obligueshme****, të cilat të gjithë tenderët duhet të respektojnë në mënyrë që të jenë të përgjegjshëm. Në disa raste, AK mund të specifikojë funksione të dëshirueshme, përformancë etj. dhe të përfshijë specifikime të tilla në kritere, mbi të cilat tenderuesit vlerësohen (parametrat e konkurrencës). Kjo do të thotë që funksionet e tilla të dëshiruara mundë të përcaktohen si nën-kritere ("karakteristikat funksionale") për tenderin ekonomikisht më të favorshëm".*

Shembull: Njohuri në të folur dhe në të shkruar **të gjuhës angleze**.

Njohuri të mira të Microsoft Office-it, programeve Word, Excel, PowerPoint, nuk janë inkorporuar

tek kërkesat e kualifikimit apo poentimit dhe nuk janë marr për baze ne vlerësim.

Për me tepër Vlerësimi i Propozimeve Teknike - Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve për vlerësimin e Propozimeve Teknike janë përcaktuar si me poshtë:

Pikët

Kualifikimet Minimale	**Kalon/Nuk kalon**
Përvojë specifike	**10-40**
Metodologjia e punës / detyrave të punës	**10-20**
Kualifikimi	**20-40**
Pikët totale	**100**

Vlerësimi i kandidateve është bere njëtrajtshëm nga te gjithë kandidatet e komisionit vlerësues te ofertave kundrejt ofertuesve. Parashtruesi i ankesës lidhur me kërkesën për "**Përvoje specifike**", nga te gjithë kandidatet është poentuar me zero pike, përderisa ne oferte ka prezantuar prova përmes te cilave vërtetohet përvoja specifike e përcaktuar ne aneksin 1 te dosjes se tenderit dhe kërkesave te kualifikimit.

Pra, vlerësimi ynë është se AK- AQP, nuk ka ndjekur rregullat e LPP-se edhe gjate vlerësimit ka bere diskriminim te qarte me vet faktin se ne arsyetim për eliminim thuhet se kandidati nuk ka kaluar pragun prej 60% te pikëve , por ne fakt AK – AQP, nuk ka ber vlerësim sipas kriterit te përcaktuar dhe nuk ka bërë poentim te kërkesave dhe specifikave teknike te cilat janë obligative sipas nenit 20.9 te RrUOPP-se, përkatësisht nenin 69, te LPP-se, pasi qe nuk janë vlerësuar në mënyre te drejte dhe objektive, kapacitet e kandidatit te propozuar për dhënie te kontratës ne lot 1, ne raport me kandidatin e eliminuar si të pa papërgjegjshëm, rrjedhimisht kriteret për vlerësim.

- Parashtruesi i ankesës përmes kërkesës për ri shqyrtim përveç tjerash ka ngritur edhe shqetësim tjetër lidhur me konfliktin e interesit, ku si prove ka prezantuar fotografi dhe pretendohet se, ofertuesi i rekomanduar për dhënie te kontratës me zyrtar përgjegjës se AAC, kanë lidhje te ngushte miqësore. Kjo qeshje nuk është trajtuar fare nga AK – AQP, siç obligohet me dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se.

Përfundimisht, Eksperti Shqyrtues konsideron se AK me rastin e inicimit të këtij aktiviteti te prokurimit nuk e ka përcaktuar qëllimin, objektin dhe lenden e kontratës pasi qe lënde e kësaj kontrate është punësimi i zyrtareve e jo blerja e shërbimeve të veçanta qysh e tregton rregullorja dhe njoftimi i KRPP-se

Prove: se bashku me raport gjeni njoftimin e KRPP-se 06/2021, dt 02.02.2021; kopje e fotografisë bashkangjitur me ankese, si dhe poentomi i kandidateve nga komisioni vlerësues.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues, vlerëson se pretendimet ankimore janë plotësisht te bazuar dhe i rekomandon Panelit shqyrtues qe ketë procedurë te prokurimit **ta anuloj ne tërësi si te kundërligjshme** , pasi qe nuk kemi te bëjmë me procedurë te prokurimit, "Shërbime te veçanta", por me rekrutim te stafit i cili është i rregulluar me Ligjin për Zyrtar Publik nr. 06/L-114.

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – "Agjencioni Qendror i Prokurimit
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - z. Armir Qorolli